

## Eficiencia e buxhetit të Bashkisë Delvinë (Viti 2020)

### 1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2020

Studimi ka për qëllim të analizojë eficiencën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2020, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifatat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

**Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve**

Burimet e financimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
<b>Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore</b> (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	81,163	787,990	39 %
<b>Të ardhurat e trashëgura</b> (nga viti i mëparshëm)	7,601	73,796	4 %
<b>Transferta e pakushtëzuar</b> (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	65,565	636,553	31 %
<b>Transferta e pakushtëzuar sektoriale</b> (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	53,854	522,854	26 %
<b>TOTALI</b>	<b>208,183</b>	<b>2,021,194</b>	<b>100 %</b>

Burimi: Bashkia Delvinë (llogaritje EIC)

**Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Delvinë 2020**



Burimi: Bashkia Delvinë (Ilogaritje EIC)

## 2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Delvinë për vitin fiskal 2020

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2020. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

**Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale**

Emërtimi i shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Shpenzime Paga + Sigurime	110,639	1,074,165	53.1
Shpenzime Operative	62,397	605,796	30
Investime	35,147	341,233	16.9
<b>TOTALI</b>	<b>208,183</b>	<b>2,021,194</b>	<b>100 %</b>


Burimi: Bashkia Delvinë (Ilogaritje EIC)

**Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale**



Burimi: Bashkia Delvinë (Ilogaritje EIC)

**Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale**



Burimi: Bashkia Delvinë (Ilogaritje EIC)